



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.05.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:03 dhe mbaroi në orën 12:05.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
2. **Klodian Kurushi** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Irena Plaku** (anëtare)
5. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Brikena Ukperaj** (anëtare)

**9. Marçela Shehu** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Klodiana Vogli, përfaqësuese – OPDAT- Ambasada Amerikane.**

**5. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**

**6. {...} (në sallë) dhe znj. {...}, përfaqësues nga ILD.**

**7. Magjistratët z. {...} dhe z. {...}.**

**8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

**9. Edmond Hoxhaj, BIRN.**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

**Ilir Rusi:** Mirëmëngjes të nderuar anëtarë!

Mirëmëngjes përfaqësues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratë!

Sipas njoftimit të bërë deklarojmë të hapur mbledhjen e ditës së sotme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës, në pikën 1 të tij kemi zhvillimin e i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Në lidhje me këtë procedim, kohë më parë është bërë edhe njoftimi nëpërmjet postës elektronike por edhe me shkresa zyrtare të subjekteve pjesë e këtij procedimi disiplinor, për të cilën është konfirmuar marrja e këtij njoftimi. Njëkohësisht në kohë janë paraqitur edhe parashtrimet nga magjistratët z. {...} dhe z. {...}, të cilat janë bërë me dije edhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të cilën është konfirmuar që për përmbajtjen e tyre është bërë me dije. Njëkohësisht edhe parashtrimet e paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në lidhje me procedimin nr. 3/2023 janë bërë me dije magjistratët z. {...} dhe z. {...}.

Sipas verifikimit, sot rezulton që përfaqësues i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është z. {...}, me detyrë inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr. 3/2023, në ngarkim të magjistratëve {...} dhe {...}, me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, që do zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, verifikohet/konfirmohet prezenca e z. {...} (prezent) dhe z. {...} (prezent).

Sipas përcaktimeve të nenit 142 të ligjit “Për statusin” do ftoja Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për të na paraqitur argumentet lidhur me faktin nëse këto shkelje disiplinore janë kryer dhe çfarë masash disiplinore propozon Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por duke pasur në konsideratë edhe mospërsëritjen e atyre parashtrimeve që keni bërë me shkrim në kohë.

Fjala për ju z. {...}.

{...}: Faleminderit z. Nënkryetar!

Atëherë, shkurtimisht, pasi ju e keni edhe raportin e gjatë edhe parashtrimet që ne jua kemi nisur me shkrim, unë do doja të fokusohesha në dy-tre momente që janë shumë të rëndësishme për nevojën e këtij procedimi disiplinor, për të vënë në dijeni shkurtimisht që ky hetim disiplinor, hetimi disiplinor ka nisur mbi bazën e informacionit periodik që ka marrë ish-Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe është regjistruar me nr. 5541, datë 29.03.2017 “Për çështjet e zvarritura mbi 2 vjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”, ku mbi bazën e këtij hetimi janë marrë 6 gjyqtarë si të hetuar, që janë znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, respektivisht nga 2 çështje deri në 10 çështje.

Më pas, meqenëse mbas marrjes së këtyre materialeve dhe pyetjes së gjyqtarëve nuk janë kryer hetime të tjera dhe meqenëse u suprimua Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, dhe në respektim të dispozitave kushtetuese, vendin e tij e zuri Inspektori i Lartë i Drejtësisë me kompetenca të plota kushtetuese dhe ligjore, për të vijuar të gjitha hetimet e papërfunduara nga ish-Inspektorati, është marrë vendimi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vijimin e këtij hetimi disiplinor i vitit 2022, në muajin korrik. Mbi bazën e këtij vendimi që ka marrë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, qëllimi ka qenë që të vijohet hetimi, të administrohen jo vetëm dokumentacioni që ka pasur në dosjen e vjetër, por të mbledhet çdo lloj dokumentacioni i nevojshëm për të vërtetuar elementë faktikë dhe juridikë, nëse ekzistojnë elementë të shkeljes së përgjegjësisë disiplinore që ka të bëjë me zvarritje të gjyqimit. Pra ky ka qenë qëllimi në kuadrin e parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Mbi bazën e këtij parimi janë marrë informacione vijuese për gjendjen e gjykimeve, proceseve gjyqësore, për të cilat kishte filluar hetimi disiplinor, në të gjitha gjykatat përkatëse, duke filluar që nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Durrës, Gjykata e Lartë, për të parë ecurinë nëse kishin përfunduar ose jo, e kështu me radhë.

Në vijim të të gjithë këtij informacioni të mbledhur ka rezultuar që, të paktën për gjyqtarin z. {...}, për një çështje (pasi për një çështje tjetër nuk janë gjetur shkelje dhe është arkivuar), por për çështjen {...}/2009, ka vonesa të konsiderueshme në gjykimin e kësaj çështjeje që kanë zgjatur 12 vite, 5 muaj e 19 ditë gjykim (dhe i papërfunduar). Atëherë, me qëllim që, sepse Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka si qëllim jo vetëm

transparencën por mbi të gjitha edhe respektimin e pavarësisë së magjistratit, për të parë që shkelja për zvarritjen e gjykimit sa ka lidhje me ushtrimin e funksionit nga ana e tij, pra që ai, le të themi, ka ndikuar në zvarritjen e kësaj çështjeje.

Një çështje, pa diskutim, nisur edhe nga praktika e konsoliduar tashmë, ka katër elementë shumë të rëndësishëm të cilat ne i marrim shumë parasysh në çdo çështje, për çdo magjistrat, që është: kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve, sjellja e autoriteteve dhe sigurisht edhe veprimet që ka kryer magjistrati.

Në analizë të këtyre elementëve, pasi kemi administruar të gjitha provat përkatëse, na ka rezultuar që në këtë kohë totale 12 vite, 5 muaj e 19 ditë, një kohë shumë e konsiderueshme prej 6 vite, 11 muaj, 14 ditë kanë qenë veprime le të themi që janë kryer në formën e neglizhencës nga ana e magjistratit dhe që kanë sjellë si pasojë zvarritjen e gjykimit. Cilat janë këto veprime?

Ne kemi analizuar në formë përmbledhëse, që disa seanca gjyqësore që shkojnë 128 ditë, zvarritja e gjykimit është bërë për shkak të mosformimit të trupit gjyqësor që nuk ka dhënë arsye për mungesën e prezencës. Për disa seanca të tjera gjyqësore, 73 ditë, zvarritja e gjykimit është bërë për shkak të marrjes së provave pasi kishte filluar hetimi gjyqësor, ndërkohë që neni 154, 154/a e kërkon qartësisht që ekzistenca e provave që shoqërojnë padinë duhet të jenë që në seancën e parë, ndërkohë ato janë kërkuar në vitin e dytë të gjykimit, pa dhënë arsye motivimi.

Tjetër – 290 ditë është shtyrë gjykimi për shkak se gjyqtari në proces gjykimi i ka dhënë mundësi palëve që të pajtohen, pra ka bërë përpjekjet e pajtimit mbas 2 vitesh gjykim dhe palët gjithashtu nuk kanë dhënë arsyet objektive përse duhesh shtyrë kjo seancë dhe kjo ka ndikuar gjithashtu në zvarritje; Dhënien mundësi avokatëve të secilës palë, të palës paditëse dhe palës së paditur që në kompromis me njëri-tjetrin kanë dashur të shtyjnë seancat gjyqësore, kur kanë qenë kushtet për pushimin e gjykimit; Gjithashtu ka ndikuar dukshëm edhe një kohë totale 255 ditë për avokatin e palës së paditur dhe 214 ditë për avokatin e palës paditëse kur kanë qenë kushtet e pushimit të gjykimit.

Për më tutje, ajo që ka ndikuar më shumë në zvarritjen e gjykimit ka qenë mungesa e marrjes së informacionit për një çështje tjetër që ka shërbyer si shkak për

pezullim, kur ky informacion mund të merrej shumë lehtë, dhe janë shtyrë katër seanca për gati 1 vit, për të marrë një informacion a ekziston apo jo një çështje tjetër midis të njëjtës palë por për një objekt të ngjashëm që ishte çështje pronësie. Pra për 1 vit ka dështuar, është shtyrë gjykimi për të marrë informacion brenda gjykatës.

Megjithatë, ky informacion që ka mbërritur në vitin 2013, mbas 5 vitesh gjykim, dhe ka shërbyer si shkak për pezullimin e gjykimit, është rihapur në vitin 2016, nuk është thënë arsyeja në procesverbal pse është rihapur, ku duhet të ishte evidentuar që çështja nuk është zgjidhur në themel, për të cilën u pezullua. Është pezulluar sërish sepse palët e kanë rihapur çështjen e konfliktit të pronësisë dhe është ringritur nga pezullimi në vitin 2018 dhe sërish nuk është evidentuar çfarë ka ndodhur me shkakun e pezullimit, me nenin 297, pika e parë, germa “a”, pasi nuk u zgjidh kurrë në themel. U vendos pushimi i gjykimit të saj dhe për këto arsye vazhdoi gjykimi. Pra e gjithë ecuria e pezullimit të çështjes nuk ka qenë kurrë efektive.

Për ta përmbyllur, e gjitha koha në total 6 vite, 11 muaj, 14 ditë, për shkak të këtyre mosveprimeve por edhe neglizhencë le të themi, në kuptim të ushtrimit të funksionit, ka bërë që Inspektori i Lartë i Drejtësisë të vlerësojë që jemi përpara kryerjes së shkëljes disiplinore, asaj që ka të bëjë me nenin 102, pika 1, shkronja “d”, zvarritje në kryerjen e veprimeve procedurale gjatë gjykimit.

Për këto arsye, nisur edhe nga tërësia e të gjithë rrethanave komplekse të kësaj çështjeje, se sigurisht edhe palët kanë ndikuar në zvarritjen e kësaj çështjeje, edhe kompleksiteti ka qenë, pa diskutim ne i kemi analizuar, kemi qenë shumë objektivë, kemi mbërritur në qëndrimin që masa disiplinore më e përshtatshme që propozojmë është ajo që ka të bëjë me “Uljen e pagës 40 % deri në 1 vit”, sikurse parashikon dispozita ligjore përkatëse, pra më konkretisht, sipas nenit 105, pika 1, shkronja “c” dhe neni 108 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, “Për ulje të përkohshme të pagës” i) deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një viti – kjo për sa i takon gjyqtarit z. {...}.

Sa i takon gjyqtarit tjetër z. {...}, edhe ai ka pasur 10 çështje nga të cilat ka filluar hetimi disiplinor, por nga të cilat, neve në fazën kur e ngritëm nga pezullimi, 7 prej tyre,

duke respektuar parimin e sigurisë juridike, ishin përtej 5 viteve që ishte dhënë me vendimmarrje, dhe për këtë arsye vendosëm arkivimin e tyre për këtë shkak. Ndërkohë për dy çështje të tjera, ashtu sikurse edhe për magjistratin tjetër z. {...} konstatuam që aty nuk kishte shkelje dhe vendosëm sërish arkivimin. Ndërkohë, vetëm për një çështje, ajo që ka të bëjë me vitin 2014, me nr. 2032/2014, konstatuam që mbas disa seancave gjyqësore shumë të mirë administruara brenda një afati të arsyeshëm, ishin kryer të gjitha veprimet procedurale të kësaj çështjeje civile, gjyqtari kishte vepruar në një kohë shumë të shkurtër. Më pas, kishte marrë vendim për pezullimin e kësaj çështjeje, për zgjidhjen e një çështjeje tjetër në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Vendimi i pezullimit është më datë 01.06.2015 (tërësisht në diskrecionin e gjyqtarit dhe në autoritetin që njeh ligji). Nga momenti i regjistrimit deri në momentin që në 2019, në muajin nëntor, kërkon dhe do ta rivë në lëvizje çështjen për të parë ka rënë ose jo shkak i pezullimit, është një kohë relativisht shumë e gjatë, pothuajse katër vjet.

Sigurisht gjykimi i çështjes së dytë, pra asaj që shërbeu si shkak pezullimi, ishte zgjidhur kohë më përpara, ishte zgjidhur që në vitin 2015, ishte zgjidhur edhe me vendim në muajin mars 2017, me vendim të Gjykatës Administrative të Apelit. Shkaku i pezullimit me vendim të formës së prerë kishte rënë që në vitin 2017. Ndërkohë, në këtë periudhë vakumi, nga muaji qershor i vitit 2015 deri në muajin tetor të vitit 2019, as palët sigurisht nuk e kanë vënë në dijeni gjykatën pa diskutim, por as gjyqtarët nuk kanë kryer veprime kryesisht në bazë të nenit 175, 179 gjithashtu, për të parë, për të administruar, sepse interesi i çdo çështjeje është që pasi palët vënë në lëvizje mbi bazën e nenit \_\_, ti duhet të marrësh të gjitha masat për të parë ecurinë e saj. Në qoftë se ka humbur ky interes apo ka rënë shkak, sigurisht ajo do procedohej me rivënien në lëvizje, sikurse e ka kryer, dhe më pas nuk janë paraqitur palët dhe është pushuar gjykimi. Por ne e kemi konstatuar që rivënia në lëvizje, pra roli që duhet të marrë gjykata, detyrueshmëria që ajo ka është mbas 3 vite e gjysmë, rreth 4 vitesh. Ndërkohë, në këtë çështje dhe në çështjen e parë me zotin {...}, janë shkelur të dy afatet, si afati 6 muajor që parashikon rregullorja e vjetër e ish-KLD-së të vitit 2010 që 6 muaj duhet të zgjasë një çështje civile, ashtu edhe neni 399/2, i Kodit të Procedurës Civile për afatin e arsyeshëm 2-vjeçar. Ajo që kemi

evidentuar neve, nuk e kemi kapur ne si institucion në tërësi, por e kemi parë të individualizuar me veprimtarinë personale të magjistratit përkatës.

Për këto arsye, në lidhje me gjyqtarin z. {...}, ne kemi mbërritur në konkluzionin si institucion, se ndaj tij duhet të jepet masa disiplinore “Vërejtje publike” parashikuar nga neni 105, germa “b” dhe neni 107, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Arsyeja e kësaj mase disiplinore që sigurisht hyn tek masat e lehta dhe ka të bëjë me faktin që shkelja disiplinore është për një periudhë relativisht jo shumë të gjatë në raport me shkeljen e parë; nuk ka pasur pasoja sepse vetë palët pasi e kanë rivënë në lëvizje nuk kanë shfaqur vullnet dhe nuk janë paraqitur (rrethana këto që i kemi mbajtur parasysh). Por gjithashtu, qëllimi i miradministrimit të drejtësisë i ka të dyja interesat, si atë të parandalimit të posaçëm, ashtu edhe të parandalimit të përgjithshëm. Pikërisht, masa disiplinore “Vërejtje publike” ka qëllimin e parandalimit përveç atij të posaçëm edhe të përgjithshëm, me qëllim që në rast të situatave të ngjashme, sjellja e magjistratit duhet të jetë në dirigjencë të plotë me të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke ndërmarrë veprime aktive sikurse e kërkon neni 298 i Kodit të Procedurës Civile.

Ju faleminderit!

Këto ishin në mënyrë të përmbledhur qëndrimi tonë në lidhje me të gjithë hetimin disiplinor të zhvilluar dhe që jua kemi përcjellë, sikurse edhe magjistratëve përkatës, nëpërmjet përfundimit të hetimit disiplinor dhe parashtrësive që ju i keni.

Ju faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit z. {...}!

Do ftoja anëtarët e Këshillit, magjistratët, nëse kanë pyetje për sa u argumentua nga përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me ekzistencën e shkeljeve disiplinore dhe masat disiplinore përkatëse.

Po, z. Hallunaj!



**Dritan Hallunaj:** Unë në fakt kam një pyetje. Pra bëhet fjalë për një vendimmarrje të magjistratit {...} dhe për dy vendimmarrje të z. {...}?

Për të dy nga një?

{...}: Të dy nga një. Por kur ka filluar hetimi z. {...} ka pasur 10 çështje mbi 2 vjet.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

Sot, që keni ardhur.. Nga një?

{...}: Një për secilin.

**Dritan Hallunaj:** Ok! Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Të dy gjyqtarët sot janë nën efektin e masave disiplinore për shkak të shkarkimit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Si e mendoni ju aplikimin e masave disiplinore, njëkohësisht më të buta, ndërkohë që ata janë në efektin e një mase disiplinore?

{...}: Dy procedimet disiplinore janë të pavarura. Procedimi disiplinor që ka të bëjë me KPK-në e dimë që është tranzitor dhe i përkohshëm dhe ka të bëjë me të gjitha kriteret e vlerësimit, profesional, integritetit dhe ekonomik. Sigurisht ne e dimë edhe statusin e tyre, që për momentin janë të pezulluar.

Procedimi jonë ka të bëjë gjithashtu me kushtetutshmërinë për të ndjekur çdo hetim disiplinor të ngelur rrugëve, për të shkuar deri në fund dhe sigurisht duke i dhënë vlerën gjithsecilit, sepse s'mund t'i shmangem kësaj përgjegjësie ligjore. Faktet për më tepër, të procedimit tonë disiplinor, për këto dy raste, nuk janë shqyrtuar nga KPK-ja në

vlerësimin përkatës. Pra nuk ka mbivendosje, që të jemi përpara gjykimit dy herë të së njëjtës çështje.

***Ilir Rusi:*** Ka pyetje të tjera?

Atëherë vazhdojmë në parashtrimin e argumenteve mbrojtëse nga magjistratët, por duke pasur parasysh edhe përcaktimin ligjor që mos të kalohet në përsëritje të atyre parashtrimeve me shkrim që keni bërë.

Po, patjetër z. {...}!

Fjalën për magjistratin {...}!

*{...}*: Nuk isha përgatitur faktikisht për një mbrojtje kaq të gjatë sa parashtrio Inspektori, sepse kisha paraqitur dy kërkesa, një më datë 18.04 dhe një datën 08.05, sipas së cilës, në mënyrë të përmbledhur, meqenëse mora dijeni që i keni marrë, të ishte administruar nga dokumentacioni i dosjes edhe kërkesat e palëve, pasi është vënë në dyshim në dosje që mungojnë kërkesat e palëve, pra mënyrën se si mund të jenë renditur aktet në dosje, kam përshtypjen që nuk janë administruar, pra si kërkesat e palës paditëse, ashtu edhe të palëve të paditura. Gjithashtu ishin marrë edhe vendimet e kalimit në seancë. Më duket nuk janë përfshirë as në pjesën e hetimit administrativ dhe as s'janë pjesë e dosjes që keni para; dhe mbasi të administronte/të kishte në dispozicion edhe IKLD-ja këto materiale, mbase të paktën të shprehej ILD-ja për atë qëndrim që do kishte për këtë vendimmarrje, për këto akte, pastaj të mbaja qëndrim edhe unë. Se e shoh që nuk është pjesë e hetimit.

Njëkohësisht, meqenëse e parashtrio edhe zonja anëtare, meqenëse ishte propozuar aplikimi i masës “Ulje e përkohshme të pagës”, pretendoj që një masë e tillë është ndaj pagës së zakonshme neto, jo ndaj pagës së reduktuar, se sot, unë të paktën paguhem me 75% të pagës. Dhe në funksion të parimit të proporcionalitetit, me masat që cenojnë sa më pak të drejtat legjitime të palës së interesuar... Pra zbatimi i këtyre ligjeve, i nenit F/5, 6 i Aneksit të Kushtetutës, nenit 62 të ligjit 84/2016, nenet 105, 108, 148 të ligjit 96/2016, dhe në përputhje të kërkesës së ILD-së, lidhen me të njëjtën pasojë

10

financiare, pra pikërisht kundër pagës neto të zakonshme; Dhe nëse kërkesa do pranohej eventualisht nga KLGJ-ja, do sillte pasoja financiare edhe në vendimin e KLGJ-së, pra do të kalonte eventualisht qëllimin e ligjit nr. 96/2016, sipas pikave 2/j, 11, 12, 22, 115/2/a, 100/1/e dhe do zbatohet pasojë e dyfishtë financiare; Vazhdimi i veprimeve administrative nga ana e KLGJ-së do ishte e ndërvarur/kushtëzuar sepse të njëjtat prova shkresore që unë kam paraqitur në ILD janë të njëjtat që kam çuar edhe në KPA. Janë të njëjtat parashtrime dhe janë lehtësisht të verifikueshme në paragrafët 54 – 62 të vendimit të KPK-së (vendim i aksesueshëm në faqen elektronike). Të njëjtat pretendime, fakte e prova i kam parashtruar edhe në KPA dhe në ILD.

Për këtë arsye unë pata kërkuar me shkrim pezullimin e procedimit deri në vendimin e KPA-së.

Njëkohësisht kisha në dispozicion edhe këto akte që në dosje mungojnë. E shoh që mungojnë, edhe në dosjen e ILD-së. Pra ishin kërkesat e palës (të avokatit të palës paditëse) ashtu edhe kërkesa e avokates së palës së paditur. Janë të gjitha të renditura sipas një formati të praktikës administrative që kishte udhëzuar Ministria e Drejtësisë për mbajtjen dhe lidhjen e akteve.

Pra duke u pezulluar kjo procedurë, në këtë fazë pretendoj se shqyrtimi i vendimmarrjes së KLGJ-së (pas vendimmarrjes së KPA-së) do ishte më efektiv në përputhje edhe me kërkesën e ILD-së dhe të ligjit 96/2016.

***Ilir Rusi:*** Keni diçka tjetër për të shtuar z. {...}?

***{...}:*** Jo!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Atëherë, para se të kalojmë tek pyetjet, doja një opinion të përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi konstatimet e bëra nga subjekti i procedimit, z. {...} (magjistrati).

{...}: Faleminderit!

E dëgjova me shumë vëmendje magjistratin {...}.

Do të thoja që qëndrimi jonë, jo në këtë rast por në të gjitha rastet, është ai që parashikon neni 126 që ka të bëjë pikërisht me arsyet e pezullimit, dhe 145 që lidhet me Këshillin e Lartë Gjyqësor, ku tekstualisht thuhet që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në qoftë se do ishim në shkaqet ligjore të pezullimit, nuk do kishim ardhur këtu, do ta kishim bërë vetë, vendos pezullimin (sikurse e kemi bërë në një rast tjetër me zotin {...}, pasi rrethanat e çështjes për të cilat ne ishim në një hetim të hapur, dhe ai i vjetër nga ish-KLD-ja, vendosëm pezullimin sepse ishin të njëjtat rrethana që kishte vlerësuar KPK-ja). Këtu nuk jemi në të njëjtat rrethana. Po lexoj dispozitën për ta pasur parasysh atë që kërkon ligjvënësi: Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke zhvilluar një hetim penal (që nuk jemi për asnjë nga magjistratët) ose një proces gjyqësor (jo proces administrativ), proces gjyqësor penalo-administrativ-civil (që as këtu nuk jemi). E vetmja pikë që plotësohet tekstualisht por jo në frymën e ligjit, është që njëra nga palët është magjistrati. Pra procesi tjetër është ai i KPK-së, që unë e shpjegova pak më lart. Kemi të bëjmë me dy procese të ndara, të pavarura. Nuk është proces gjyqësor për më tepër. Por edhe sikur t'i japim vlerën substanciale të një procesi gjyqësor nuk janë të njëjtat fakte. Për sa kohë s'janë të njëjtat fakte përgjegjësia ligjore është që ky proces disiplinor të përfundojë, pra të shqyrtohet, të vijohet më tej, sikurse e kërkon ligji 96/2016 "Për statusin".

**Ilir Rusi:** Po në lidhje me faktin që ka mungesë dokumentacioni?

{...}: Ne kemi administruar të gjitha procesverbalet e seancave gjyqësore, ky është fakt, të gjitha procesverbalet e seancave gjyqësore dhe veprimtaria jonë ka qenë e bazuar mbi atë që një procesverbal gjyqësor, neni 117 i Kodit të Procedurës kërkon, duhet të jetë i plotë, duhet të jetë i plotë dhe të përcaktojë në mënyrë shteruese secilën palë të pranishme, çfarë kërkoi, çfarë paraqiti, pra duhet të dalin qartësisht. Në qoftë se ti nuk i ke renditur këto që t'i kërkon ligji... Të gjitha këto rrethana nuk i ke pasqyruar, është

12

pikërisht mosushtrim funksioni që është një tjetër shkelje, përtej zvarritjes sepse këtu jemi tek zvarritja. Mospasqyrimi i saktë i të gjitha këtyre rrethanave në procesverbal do shkonte te një tjetër shkelje, do kishte të bënte me nenin 102, pika 2, germa “a” – mosushtrimi i funksionit për shkelje të rënda. Por këtu s’jemi në një vendimmarrje në fund të fundit dhe e kemi konkretizuar vetëm tek zvarritja e gjykimit.

**Ilir Rusi:** Faleminderit z. {...}!

Ftoj anëtarët nëse kanë pyetje.

Po, znj. Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Për përfaqësuesin e ILD–së: Është administruar e gjithë dosja gjyqësore, e gjithë dosja gjyqësore siç ka qenë, me të gjitha aktet e dosjeve? A është administruar apo janë administruar vetëm procesverbalet?

{...}: Të gjithë procesverbalet e zhvillimit të seancave gjyqësore.

**Brikena Ukperaj:** Pra nuk është administruar e tërë dosja?

{...}: Edhe kërkesat që kishin bërë, në mos gaboj kërkesat për pezullim, kërkesat për shtyrje. Se s’e kam tani dosjen.

Thelbi jonë është procesverbalet e seancave gjyqësore, për të parë pasqyrimin në çdo procesverbal të seancave gjyqësore arsyet për të cilat është shtyrë njëra seancë në tjetrën. Dhe po e përsëris, procesverbali i seancës gjyqësore është akti më i rëndësishëm ku dokumentohet në mënyrë shteruese...

**Brikena Ukperaj:** E dimë rëndësinë e procesverbalit.

Pyeta a është administruar dosja gjyqësore?

{...}: Kam marrë të gjithë procesverbalet. Kështu ka qenë edhe më përpara.

**Brikena Ukperaj:** Z. {...}, jeni njohur ju me raportin e hetimit, raportin përfundimtar të hetimit?

{...}: Duke parë ecurinë e hetimit administrativ, me atë jam njohur dhe pikërisht duke parë atë material, shoh se mënyra e renditjes së akteve... nuk e kam personale si gjyqtar. Që nga 2002 që është bërë kontroll në këtë gjykatë, është orientuar nga hetimi që kishte bërë ministria, KLD-ja në gjykatë, që një renditje e përshtatshme e akteve mund të jetë padia, provat e paditësit, kërkesat e palëve paditëse; pastaj fillojnë provat e palës së paditur, kërkesat e palës së paditur; pastaj fillojnë vendimet e kalimit në seancë, njoftimet dhe procesverbali.

Të gjithë këto kërkesa që pretendohet të paktën në hetimin administrativ, janë të renditura me kërkesa, me raporte mjekësore, në anën e provave të paditësit. Kërkesat e avokatit të palës së paditur janë të gjitha të renditura tek provat e palës së paditur. Pastaj fillojnë vendimet e kalimit në seancë, fletëthirrje dhe proces.

**Brikena Ukperaj:** Ju pretendoni që janë në dosje.

{...}: Janë në dosje të gjitha.

I di edhe ku janë.

**Brikena Ukperaj:** Pyetja tjetër.

Thatë që keni ngritur të njëjtat pretendime edhe pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

{...}: Të njëjtat akte që janë këtu, provat shkresore, të gjitha atje.

**Brikena Ukperaj:** Pse? Për çfarë arsye?

Ka qenë objekt hetimi apo është ngarkuar barrë prove? Si ka qenë problemi?

{...}: Është pretenduar për një zvarritje.

**Brikena Ukperaj:** Edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit?

{...}: Të njëjtat letra që janë tek ky hetim, që i kam çuar ILD-së, të njëjtat letra i ka edhe KPA-ja dhe KPK-ja. Janë të renditura. Edhe po të shikoni ato faqe që unë ju rendita, shikoni tek ai vendimi i aksesit “online”, i ke të renditura aty.

**Brikena Ukperaj:** Nuk kam pyetje.

{...}: Të njëjtën gjë kam pretenduar edhe në KPA pastaj.

**Ilir Rusi:** Faleminderit znj. Ukperaj!

Ftoj anëtarët e tjerë nëse kanë pyetje apo ndonjë diskutim.

*(Nuk ka pyetje në vijim.)*

Atëherë në vijim vazhdojmë me argumentat mbrojtëse të parashtruara nga z. {...}.

Fjala për ju zoti magjistrat, duke ju kërkuar për të mos kaluar në përsëritjen e parashtrimeve me shkrim paraqitur nga ana juaj sepse ato, sikundër e theksova, ia u kemi shpërndarë anëtarëve, njëkohësisht i kemi vënë në dispozicion edhe përfaqësuesit të ILD-së. Do donim të ndaleshit tek argumentet mbrojtëse.

{...}: Faleminderit!

Unë nuk kam gjë tjetër veç atyre që kam parashtruar me shkrim, por gjatë kësaj kohe kam një përvojë shumë negative me institucionet. Përvoja është që ato nuk i lexojnë. Unë nuk para dyshoj që gjyqtarët të mos e kenë lexuar atë parashtrimin tim, por më ka ndodhur me KPA-në që pretendimet që parashtrova nuk janë marrë fare në shqyrtim dhe as nuk janë lexuar, dhe kanë arritur në përfundime sipas idesë së tyre.

Prandaj në qoftë se ju e keni lexuar, mund të shtoj dy gjëra përmbledhtazi sepse s'është e nevojshme, është një material prej 13 faqesh.

Unë do të thosha shkurtimisht që unë e kam pezulluar atë gjykim për shkak se ishte një gjykim për kundërshtim të një vendimi të Komisionit të Pronave. Gjatë gjykimit rezultoi që prona që pretendohej, ishte kompensuar. Pretendohej e lirë, doli e zënë. Kishte një certifikatë pronësie të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Gramshit. Ishte regjistruar në bazë të ligjit me një titull pronësie tapie, ligji "Për tokën". Në bazë të ligjit "Për kthimin e pronave", konsiderohej e zënë dhe padia do rrëzohej.

Gjatë kësaj kohe, duke qenë se erdhi në dijeni të këtij fakti, përfaqësuesi i paditësit ishte avokat, kishte bërë një padi në Gjykatën Administrative pa ma thënë në fillim mua (d.m.th. diku nga dhjetori 2014). Pasi shkuam atje ku bëmë edhe ekspertimin dhe rezultoi ky fakt, më paraqiti një vërtetim që të gjykohej njëherë ajo në Gjykatën Administrative, se ne pretendojmë që toka që ka marrë ai nuk ndodhet në fakt atje ku është regjistruar, dhe për këtë shkak unë e pezullova sepse do të varej nga ajo. Mund edhe të mos ishte pezulluar. Tani po them, gabim kam bërë pse e pezullova sepse unë e rrëzoja padinë; ai të mbaronte gjykimin administrativ; bënte një kërkesë për rishikim; e zgjidhte ai. Por për të mos e lënë atë dyerve të gjykatave, vendosa ta pezulloj. Thashë të mos bëj dy gjyqe sepse kështu e kisha idenë, ishte më mirë të mos... e pezulloj dhe... Nuk kam kërkuar në fakt sepse praktika ime ishte që unë nuk kërkoja, për një kohë të shpejtë, të verifikoja ka rënë shkak apo jo. Pala kishte avokat. Sapo të mbarojë gjyqin atje, do vijë të kërkojë.

Atëherë filloi edhe hedhja e çështjeve në sistem. Praktika ime është që unë i verifikoja të gjitha çështjet që kisha nëpër gjykata të ndryshme (që nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit). Në fund të çdo jave hapja sistemin dhe shikoja. Futja emrin (se atëherë kërkohehin me emër), dhe arrija... Kjo çështje nuk më dilte. Se kishte edhe një çështje tjetër në Gjykatën Administrative. Ishin pezulluar thuajse në të njëjtën kohë. Nuk dilnin. Në Gjykatën e Apelit Administrativ dilte e pambyllur.

Epo, thashë unë, këta do të kërkojnë vetë.



Nuk kërkova me thënë të drejtën sepse ashtu e kuptoja ligjin. Neni 298, në fakt, sipas mendimit tim nuk detyron gjykatën që të kërkojë informacion. Interpretimi që i bën Inspektori mendoj që është i gabuar. Gjykata mund të marrë masa të tjera që mund të ndikojnë në shmangien e pengesës ose të pezullimit, por jo të kërkojë/të verifikojë a ekziston shkak apo jo, se kjo në fakt është gjë shumë e thjeshtë.

Nuk e di, po ta mendoja kështu, sigurisht do kisha kërkuar. Unë gjykoja 300 çështje në vit vetëm padi. Edhe të mos bëja një veprim kaq të thjeshtë?! Ta lija kot.

Gjithsesi, si kaloi një kohë relativisht e gjatë, mendova të kërkoj njëherë. Edhe më erdhi vendimi nga Gjykata Administrative. Ishte rrëzuar padia. Me rrëzimin e padisë kishte mbaruar edhe padia tjetër. Sigurisht nuk do të pranohej. I thirra palët. Nuk erdhi paditësi se s'kishte pse të bënte shpenzime të tjera më. E pushova, dhe kaq qe.

Unë kisha një ngarkesë shumë të madhe në atë periudhë. Jo unë, por ata që kanë qenë gjyqtarë në atë periudhë e dinë. Gjykata e Elbasanit kishte të paktën 4 gjyqtarë, dhe erdhi duke u pakësuar organika vit pas viti. 4 gjyqtarë mangët. Nga 14 në organikë, kishte 10. Ngarkesa filloi të rritej, e rritej, dhe vajti, domethënë duhet të jepja edhe 600–700 vendime në vit. Ishte ngarkesa aq e madhe sa unë thosha, të mbaroj gjyqet me këta që kam këtu, se ata që janë të pezulluar, sapo të bie shkak, do të vijnë vetë. Do të vijnë vetë. Por unë dua t'ia mbaroj këtyre që kam në proces.

Unë them, nuk kam bërë shkelje, -sipas mendimit tim.

Interpretimi që i bën 298–ës, paragrafi 4, Inspektori, mendoj se është i gabuar. 298/4 parashikon: gjykata merr masa për të mënjanuar pengesa. Të mënjanosh pengesa do të thotë ti të ndikosh që pengesa, atje ku ekziston, të zhduket. Pengesa mund të ekzistojë kur pezullohet gjykimi, por edhe mund të mos ekzistojë. Për shembull unë kam bërë gjykim sepse në një gjykim familjar më ka rastisur që palët të kishin fëmijë por nuk e kishin të regjistruar, nuk kishte çështje të ngritur. Megjithatë unë e pezullova gjykimin, se kjo çështje në fakt nuk mund të zgjidhej pa u zgjidhur njëherë procesi administrativ që ishte regjistrimi i fëmijës. Pra pengesa mund të ekzistojë por mund të mos ekzistojë. Të themi procesi civil, penal, ose administrativ mund të mos jetë i ngritur por duhet të ngrihet. Për shembull kur pala humbet zotësinë, duhet të ngrihet një proces tjetër; ky

pezullohet; procesi duhet të ngrihet më pas dhe gjykata mund të ndikojë. Mund ta kërkojnë vetë palët, por po s'e kërkuan palët, gjykata duhet t'i kërkojë prokurorit. Pra duhet të kërkojë të iniciohet procesi për... (lihet mendimi përgjysmë). Unë them, me një interpretim të ngushtë, 298, paragrafi 4 thotë për masat, jo për verifikimin. Mirëpo ndodh siç më ndodhi mua, palët e zgjidhën këtë punë me drejtësinë që në vitin 2017, kur u dha vendimi nga Gjykata Administrative. S'kishin më interes. Po mos ta bëjë gjykata vetë kryesisht? Çështja mbetet e varur kot dhe rri kot. Thjesht në statistikat e shtetit ekziston një çështje që rri varur për gjykim, ndërkohë palët e kanë zgjidhur problemin edhe mes vetes edhe me drejtësinë.

Gjithsesi po e çmuat juve se unë kam bërë shkelje, unë mendoj se nuk janë kushtet për të dhënë "Vërejtje publike". Janë dy lloj masash që jepen: është masa "Vërejtje konfidenciale" dhe "Vërejtje publike". Ndryshimi mes tyre është vetëm se kur shkelja është bërë publike, atëherë jepet vërejtja publike. Kur nuk është publike, nuk jepet "Vërejtje publike", por jepet konfidenciale.

Unë nuk mund ta lija karrierën time – unë jam vlerësuar tre herë nga ish-KLD-ja dhe jam vlerësuar "Shumë mirë" – nuk mund ta lija për një letër të tillë. Unë kam parë gjyqtarë në fakt, dhe të gjykatës ku punoja. Kam parë një dosje atje, kishte 100 faqe vetëm me kërkesa të tilla, dhe ato bëheshin çdo javë. Thosha unë, – si ka mundësi që të mbushet dosja vetëm me këto fletë, se këto s'duhet të jenë këtu? Se ne jemi gjyqtarë atje dhe pyesim njëri-tjetrin, a e mbarove, ose në sekretari. Pra ky është një verifikim që bëhet. Unë pothuajse e kam bërë. Nuk e kam bërë me këtë formalizmin që thotë inspektori. Këtë nuk e kam bërë.

**Ilir Rusi:** Z. {...}, është e qartë për çfarë ju parashtroni, se po kaloni tek përsëritja e argumenteve.

Ne i kemi lexuar, sikundër ju thashë.

Përfundimisht, për vijimin e procedimit disiplinor, çfarë kërkon ju?

{...}: Kam edhe diçka tjetër për të thënë, që është e rëndësishme.

Hetimi ka nisur për sjelljen time deri në dhjetor të 2016–ës dhe Inspektorati atëherë e ndërpreu procedurën. Ndërkohë, në hetim është përfshirë edhe mosveprimtaria ime pas vitit 2016. Inspektori nuk ka bërë një vendim për të shtuar objektin e hetimit, për të përfshirë të gjithë periudhën derisa... Kështu që, në këtë aspekt, veprimtaria ime pas vendimit të parë, që është i marsit të vitit 2017, nuk duhet të merret në konsideratë sepse nuk ka vendim për ta hetuar këtë sjellje.

***Ilir Rusi:*** Atëherë, çfarë kërkon përfundimisht?

{...}: Unë them që nuk kam kryer shkelje, ose edhe po të konsiderohet shkelje nuk besoj se ka nevojë për ndonjë masë disiplinore, sepse nuk ka ardhur asnjë pasojë për palët. Unë kam theksuar në parashtrimin tim që palëve nuk u është cenuar e drejta për gjykimin brenda një afati, sepse ata janë treguar vetë pasiv fare dhe nuk kanë shfaqur interes. Pra për palët nuk ka asnjë dëm, nuk besoj se ka ardhur ndonjë dëm.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit z. {...}!

Ftoj përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëse...

{...}: Po, e dëgjova me shumë vëmendje magjistratin z. {...}, i cili ka të drejtën e tij të bëj mbrojtjen e interesave pa diskutim, por do doja të theksoja edhe një herë, në aspektin objektiv, neve, e para njëherë kemi analizuar, sikurse e përmenda edhe në fillim, gjithë atë veprimtari 7–mujore të tij në seancat gjyqësore që ka kryer, të gjithë pasivitetin që ai e përmendi dhe e analizon sikur nuk ka qenë detyrim, ne e kanalizojmë ndryshe atë që kërkon urdhërimi i nenit 298 dhe sigurisht edhe neni 2 i Kodit të Procedurës Civile. Në momentin që palët e investojnë gjykatën, gjykata merr rolin kryesor, rolin aktiv. Pa diskutim parimin e disponibilitetit e kanë palët. Edhe vendimmarrjen në diskrecionin e vendimit të pezullimit, është e drejta e tij ligjore ta marrë, por mbas këtij momenti, gjykata ka detyrueshmërinë e interesit publik dhe të asaj çështjeje për ta verifikuar çdo gjashtë muaj kryesisht se ka rënë apo jo. Kjo është praktikë e konsoliduar përveçse

ligjore. Që do të thotë, pa diskutim ata humbën interesin, nuk patën më vullnet, nuk mohohet. Por nëse do ishin kryer çdo gjashtë muaj veprimet e duhura që kërkon ligji, vendimi i pushimit të gjyqimit, ndoshta për mosparaqitje të palëve, do ishte bërë shumë kohë më përpara. Por kjo tregon edhe një seriozitet tjetër që, çështjet mos të rrinë stok pranë gjykatave edhe kur nuk ka arsye thelbësore për t'u shqyrtuar. Çdo çështje duhet të marrë drejtimin që i takon, përfshi edhe heqjen dorë, kur një palë heq dorë, s'paraqitet/s'ka vullnet. I takon roli i gjykatës të veprojë.

Problemi tjetër: Po, e vërtetë është, në dhjetor të vitit 2016, kur ka filluar hetimi, këto çështje ishin mbi 2 vjet, por është lloji i shkeljes që është vazhduese (*përsëritet fraza e fundit*). Nuk ndërpritet aty. Theksuam që të gjitha ato çështje që ishin përfunduar më pas dhe ka kaluar afati 5–vjeçar i parashkrimit, përfshirë 7 çështjet e gjyqtarit Ramazan, janë mbyllur. Ndërkohë edhe çështje të tjera që janë mbyllur më vonë janë analizuar në tërësinë e tyre, që kanë shkuar edhe mbi 2 vjet, por janë analizuar aspekte objektive, dhe nuk është vënë para përgjegjësisë disiplinore askush në mënyrë të pamerituar. Këtu flasim për këtë afat që shkon rreth 3 vjet e 9 muaj që nuk është kryer asnjë veprim procedural.

***Ilir Rusi:*** Dhe çfarë kërkon për vijimin më tej të procedimit disiplinor?

{...}: Asaj që thamë edhe në fillim, që të vijojë, të vazhdojë, sepse nuk ekzistojnë kushtet e pezullimit.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

{...}: Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Meqenëse ne dëgjuam argumentet mbrojtëse të subjekteve të këtij procedimi, përfaqësuesit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me kundërargumentet pas parashtrimit të argumenteve mbrojtëse të magistratëve, pati edhe

20

pyetje dhe me sa shikoj unë nuk ka më diskutime për këtë çështje, deri në këtë moment, do ftoja përfaqësuesin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe subjektet të largoheshin, me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet dhe t'ju njoftojë për ecurinë e mëtejshme të këtij procedimi po tani.

Ju ftoheni të dilni nga salla e mbledhjes, ne të vazhdojmë me diskutimet dhe do t'ju njoftojmë për më tej.

*(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së z. {...} dhe dy magjistratët z. {...} dhe z. {...}. Vijon diskutimi i çështjes nga ana e Këshillit pa praninë edhe të të tretëve të cilët ndodhen të pranishëm “online”. Më tej futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së dhe magjistratët për t'u njohur me vendimmarrjen e Këshillit. Gjithashtu mundësohet edhe lidhja për të tretët nëpërmjet platformës.)*

*Zoti Rusi u njofton vendimmarrjen e Këshillit palëve në këtë procedim disiplinor:*

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 145 të ligjit 96/2016 “Për statusin”, vendosi:

1. Pezullimin e vijimit të procedimit disiplinor nr. 3/2023 në lidhje me magjistratët z. {...} dhe z. {...}, deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesave tuaja nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, për shkak të ankimeve që keni bërë ju në lidhje me vendimmarrjet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Me deklarimin e këtij vendimi, seanca dëgjimore e juaja është e përfunduar dhe për më tej është e pezulluar.

*(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe dy magjistratët z. {...} dhe z. {...}.)*

\* \* \*

(Pikat 1 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

21

---

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 11.05.2023 (Pika 1)***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.05.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t’u komanduar në pozicionin ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë” (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:03 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikëna Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

22

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 11.05.2023 (Pika 2)***

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*3. Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Klodiana Vogli, përfaqësuese – OPDAT – Ambasada Amerikane.*

*5. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

*6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

*7. Edmond {...}j, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtim i projektvendimit “Për dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t’u komanduar në pozicionin ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë” (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Në vijim të rendit të ditës po vazhdojmë me pikën 2, shqyrtimi i projektvendimit “Për dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t’u komanduar në pozicionin ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë”. Për më tej fjala relatorit, z. Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 79, shkronja “b”, dhe 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016, si dhe në nenet 8, 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 156, datë 29.03.2023 ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë. 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë për 5 (pesë) pozicione “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.”.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 13 prill.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë paraqitur fillimisht 7(shtatë) kërkesa nga kandidatët.

Me shkresën nr. {...}, datë 07.04.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarit z. {...}, i cili ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Z. {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.

Me shkresën nr. {...}, datë 12.04.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarit z. {...}, i cili ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Edhe ky gjyqtar ka shfaqur vullnetin e tij për t’u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.

Me shkresën nr. {...}, datë 12.04.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.

Me shkresën nr. {...}, datë 13.04.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.



Me shkresën nr. {...}, datë 13.04.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.

Me shkresën nr. {...}, datë 13.04.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 13.04.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.

Me shkresën nr. {...}, datë 19.04.2023, gjyqtarja {...} ka deklaruar se është tërhequr nga kandidimit për pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë.

Në vendimin nr. 156, datë 29.03.2023 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli.

Konkretisht në pikën 11, Kreu II të këtij vendimi parashikohet “11. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.”

Në pikat vijuese të këtij Kreu parashikohet procedura e mëtejshme që ndiqet: 12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës së Lartë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e ndihmësmagjistratit,

dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre. 13. Gjykata e Lartë vlerëson aplikimet e kandidatëve dhe i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur. 14. Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata e Lartë.

Gjithashtu në këtë vendim është parashikuar edhe rasti kur asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit ose kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet nga Gjykata e Lartë, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rihap procedurën e komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Vlerësimi i Komisionit –

Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 156, datë 29.03.2023 të Këshillit në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.

Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton projekt-opinionin për gjithsej 6 (gjashtë) kandidatë në kushtet kur znj. {...} u tërhoq nga kandidimi, dhe përkatësisht përgatitet projekt-opinionin për magjistratët: z.{...}, z.{...}, znj.{...}, znj.{...}, znj.{...} dhe znj.{...}.

Në përgatitjen e këtij projekt-opinionin për këta kandidatë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushtet ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit –

Për z. {...}

Kriteret e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, po ashtu

kritere të posaçme të përcaktuara në pikën 8, Kreu II të vendimit të Këshillit nr. 156, datë 29.03.2023. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se: “Kriteret e komandimit janë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:

i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;

ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;

d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

dh) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, anëtarët e tjerë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8, pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me kriteret e komandimit sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 8, të vendimit të përmendur më lart, sipas informacionit të marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidatit, rezulton se:

Zoti {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 13.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

Me vendim nr. 467, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ai është emëruar gjyqtar.

Me vendim nr. 515, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në datë 13.03.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, funksion të cilin e ushtron dhe aktualisht.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 2 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Lidhur me kriteret e komandimit – kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale – z. {...} ka nënshkruar vetëdeklarimin datë 08.04.2023 sipas të cilit: “Nuk do të ndodhem në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, anëtarët e tjerë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidati {...} dhe dokumentet në dosjen personale rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

Në këto kushte, për këtë gjyqtar, nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës –

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, në kushtet kur sipas vendimit të Këshillit nr. 135, datë 28.03.2023, ku përcaktohet se: “Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.”, pas datës 01.05.2023 rezulton në organikën e gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, – mendimi i është marrë zëvendëskryetares së kësaj gjykate. Sipas këtij mendimi të përcjellë rezulton se:

Në strukturën organike të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është miratuar në strukturë një numër prej 7 gjyqtarësh, aktualisht në gjykatat Kukës e Tropojë, ushtrojnë detyrën 5 gjyqtarë, përfshirë z. {...}.

Ngarkesa aktuale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës është si më poshtë: Zoti {...} në ngarkesën aktuale ka një numër çështjesh në gjykim në total prej 65 çështjesh.

Ndër gjyqtarët që ushtrojnë detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, z. {...}, për arsye shëndetësore nuk ka gjykuar çështje gjyqësore që nga muaji dhjetor 2022 duke akumuluar një numër prej 342 çështjesh në gjykim, që potencialisht do të rishortohen mes gjyqtarëve të mbetur të të dy gjykatave Kukës e Tropojë.

Duke konsideruar ngarkesën aktuale prej rreth 850 çështjesh në gjykim, duhet theksuar se ulja e numrit të gjyqtarëve efektiv nga 4, në 3 gjyqtarë, nuk do të ketë një efekt pozitiv (sipas vlerësimit tonë) në performancën e gjykatës.

Një problematikë që mund të shfaqet nëse do të mbeten 3 gjyqtarë, do të jetë edhe pamundësia për të formuar trupa gjyqësore me 3 gjyqtarë në çështjet penale themeli, në të cilat do të konsumohen gjyqtari i hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake.

Nga sa me sipër mendojmë që për një funksionim normal të punës, organika faktike e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës duhet të jetë jo më pak se 5 gjyqtarë, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, në vijimësi ka paraqitur nevojë për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore të veçanta.

Për sa i përket (është vlerësimi i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës pra) komandimit të z. {...} në Gjykatën e Lartë, efektet eventuale mbi performancën e gjykatës në tërësi u evidentuan si më lart, por vendimmarrja mbetet në vlerësimin tuaj.

b. {...} –

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, janë të njëjta me kriteret ndaluese të komandimit edhe siç i përmenda më lart për zotin {...}.

Nuk përmenden pasi janë të njëjtat kriteret dhe të njëjtat situata siç u parashtuan për z. {...}.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesi të lartë) të gjykatës –

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesi të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, opinioni i është marrë zëvendëskryetares së gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan. Sipas këtij opinioni rezulton se:

“Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bej me dije se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan ushtrojnë detyrën 6 gjyqtarë. Aktualisht gjyqtari z. {...} është në vetting dhe ditën e hënë pritet shpallja e vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për këtë gjyqtar (materiali është paraqitur përpara se të ndodhte ajo ngjarje që i referohet shqyrtimit të çështjes së z. {...} në KPK). Aktualisht gjykata ka në gjykim rreth 4389 çështje sipas raportimit të kryer se fundmi në KLGJ, për të cilën po ju paraqes tabelën si më poshtë. Tabela është e integruar në relacion. Përmendet vetëm z. {...} i cili ka 420 çështje civile, 445 çështje penale, dhe totali i çështjeve për këtë gjyqtar është 865 çështje.

Nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të vendosë komandimin e gjyqtarit {...} në Gjykatë të Lartë, atëherë në kuadër të hartës së re gjyqësore do i kërkoja Këshillit që të hapte sa më parë të ishte e mundur plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila behet me 18 gjyqtarë, nëpërmjet lëvizjes paralele apo transferimit të përkohshëm, sepse ngarkesa me çështje gjyqësore është shumë e lartë.

c. {...} –

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit – janë të njëjta me ato që unë i përmenda më lart. Nuk ka ndonjë situatë specifike që t’jua evidentoj.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës –

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, në kushtet kur sipas vendimit të Këshillit nr. 133, datë 28.03.2023, përcaktohet se: “Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në një pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”, pas datës 01.05.2023 rezulton në organikën e gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, – mendimi i është marrë zëvendëskryetarit të kësaj gjykate. Sipas këtij mendimi të përcjellë ka rezultuar se:

“Aktualisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë funksionon dhe përbëhet nga 3

(gjqtarë). Me transferimin e gjyqtarëve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, përbërja e gjykatës shtohet edhe me 2 (dy) gjyqtarë të tjerë.

Referuar vendimit nr.133, datë 28.03.2023 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë do të ketë në organikën e saj 11 gjyqtarë. Si një nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, pritët që kjo gjykatë të plotësohet në vijim me magjistratë, të cilët do të emërohen në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2022–2023.

Për sa më sipër, vlerësoj se nuk dëmtohen interesat e kësaj gjykate në drejtim të funksionalitetit të saj, nga komandimi i Gjyqtareve {...} dhe {...} në pozicionin e Ndhmësit Ligjor në Gjykatën e Lartë. Ngarkesa e gjykatës mund të menaxhohet, duke mbajtur në konsideratë se organika prej 11 gjyqtarësh në gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Lezhë do të plotësohet me emërimin e magjistratëve të rinj.”

d. {...} –

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit – janë të njëjtat dhe nuk ka një situatë specifike që unë mund t’jua bëja prezent mbledhjes.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës –

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, mendimi i është marrë zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sipas këtij mendimi të përcjellë rezulton se:

“Aktualisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë funksionon dhe përbëhet nga 3 (gjqtarë). Me transferimin e gjyqtarëve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, përbërja e gjykatës shtohet edhe me 2 (dy) gjyqtarë.

Referuar vendimit nr.133, datë 28.03.2023 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë do të ketë në organikën e saj 11 gjyqtarë.

Për sa më sipër, vlerësoj se nuk dëmtohen interesat e kësaj gjykate në drejtim të funksionalitetit të saj, nga komandimi i gjyqtareve {...} dhe {...} në pozicionin e Ndhmësit Ligjor në Gjykatën e Lartë. Ngarkesa e gjykatës mund të menaxhohet, duke

mbajtur në konsideratë se organika prej 11 gjyqtarësh e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë do të plotësohet me emërimin e magjistratëve të rinj.”

e. {...} –

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit – janë të njëjta me ato të kandidatëve të tjerë.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës –

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, mendimi i është marrë zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Sipas këtij mendimi të përcjellë rezulton se:

“Ju bëj me dije se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht e ka organikën me 14 gjyqtarë, por aktualisht ushtrojnë funksionet pranë kësaj gjykatë 7 gjyqtarë. Ndërkohë, gjyqtare znj. {...} është me leje të papaguar deri në datë 31.05.2023; Gjyqtare {...} dhe gjyqtar {...} janë transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...} kanë filluar punë në datë 26.07.2022; Gjyqtarja {...} është komanduar pranë KLGJ prej datës 11.04.2023.

Sa më sipër, duke mbajtur parasysh ristrukturimin e gjykatave të rretheve gjyqësore të cilat prej datës 01.05.2023 do të fillojnë të funksionojnë si Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe pjesë do të jenë edhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si dhe qëllimin e komandimit pranë Gjykatës së Lartë, rrethanat profesionale dhe familjare të gjyqtares, mendoj se komandimi nga ana e Këshillit, nuk do të sillte cenimin e funksionalitetit të gjykatës.”

f. {...} –

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit – janë të njëjta me ato që përmenda më lart për kandidatin e parë dhe janë po të njëjta edhe me kandidatët e tjerë që parashtrova në vijim të këtij relacioni.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës –



Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, mendimi i është marrë zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Sipas këtij mendimi të përcjellë rezulton se:

Me urdhrin nr. 93 datë 04.11.2013 të Kryetarit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Berat është vendosur shkrirja e dhomave civile dhe penale në një dhomë të vetme. Ngarkesa e gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat është paraqitur në tabelën që është e inkuadruar në këtë relacion. Zonja {...}, çështjet e mbartura për vitin e mëparshëm janë 235, nga data 1 janar i këtij viti ajo ka 142 çështje në shqyrtim, çështje të shqyrtuara janë 131 dhe çështje në shqyrtim janë 246. Gjyqtarja {...} është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat në datë 25.07.2022 dhe vijon të ushtrojë detyrën e gjyqtares pranë kësaj gjykate. Ngarkesa aktuale e kësaj gjyqtareje është 246 dosje në shqyrtim. Për sa më sipër shpreh mendimin që Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të vendosi në varësi të ngarkesës së punës së kësaj gjyqtareje si dhe duke mbajtur në vëmendje se në rast të transferimit të saj ky numër i lartë i dosjeve duhet të rishortohet në gjyqtarë të tjerë.

Rishpërndarja e dosjeve do të sillte një ngarkesë më të madhe për këta gjyqtarë, por edhe për mbarëvajtjen e punës në lidhje me palët të cilët ende nuk kanë marrë zgjidhje gjatë periudhës që gjyqtare {...} e ushtron detyrën, dhe që është një periudhë relativisht e shkurtër.”

Në kushtet e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, përballë ngarkesës së çështjeve që kanë këto gjykata dhe pritshmërisë pozitive që do të sjellë: i) zbatimin e hartës së re gjyqësore; ii) masat e marra nga Këshilli me vendimet e datës 28.04.2023 (këto masa i referohen rastit të gjyqtarëve që ishin mbi organikë dhe një pjesë e të cilëve në i kemi caktuar si gjyqtarë në gjykatat e rretheve gjyqësore Elbasan znj. {...} dhe z. {...} nga Gjykata Kukës e kemi caktuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Lezhë); iii) masat e propozuara nga Komisioni për hapjen e vendeve për transferim të përkohshëm në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë si edhe për lëvizje paralele në këto gjykata; iv) hyrjeve të reja në sistem në korrik 2023; nuk passjell cenim të interesave të larta të gjykatave të mësipërme për sa kohë funksionaliteti i tyre do të vijojë të ruhet.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

T'i dërgohen Gjykatës së Lartë emrat e z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat kanë aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "ndihmësmagjistrat" në Gjykatën e Lartë, si dhe praktikant dokumentare të paraqitura prej tyre në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

Atëherë, në vijim hedhim në votim projektvendimin e propozuar nga relatori përkatës në lidhje me dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t'u komanduar në pozicionin "Ndhmësmagjistrat" në Gjykatën e Lartë.

***Irena Plaku:*** Pro për dërgimin e emrave, por vlerësoj që qëllimi efektiv i këtyre magistratëve duhet të vonohet, për shkak se duhet së pari të çojmë magistratë, me qëllim që të përballohet ngarkesa që kanë secila nga gjykatat dhe në formimin e trupave gjyqësor.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord. Gjithashtu nga ana e KZHK-së është menduar që efektet e

këtij vendimi fillojnë në momentin që të plotësohen edhe me magistratët e rinj vendet vakante.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Ilir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1.T’i dërgohen Gjykatës së Lartë emrat e z. {...}, z. {...}. znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat kanë aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë, si dhe praktikant dokumentare të paraqitura prej tyre në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.05.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës znj. {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013–2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores pranë Inspektoratit të Ish–Këshillit të Lartë të Drejtësisë” (relatore znj. Brikena Ukperaj).

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:03 dhe mbaroi në orën 12:05.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

36

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 11.05.2023***

9. *Marçela Shehu* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Rezarta Taushani, Vjollca {...}, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Klodiana Vogli, përfaqësuese – OPDAT – Ambasada Amerikane.*

5. *Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës znj. {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013–2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektore pranë Inspektoratit të Ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë” (relatore znj. Brikena Ukperaj).

*Ilir Rusi:* Në vijim të rendit të ditës vazhdojmë me pikën 3: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës znj. {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013–2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektore pranë Inspektoratit të Ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Për më tej fjalën relatores znj. Ukperaj.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

37

Gjyqtarja {...} është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016 në cilësinë e inspektore pranë ish–Inspektoratit të KLD–së. Ajo ka punuar tek seksioni i vlerësimeve.

Në pjesën e parë të projektraportit të vlerësimit pasqyrohet qëllimi dhe procedura e vlerësimit si dhe evidentohen të gjitha burimet e vlerësimit dhe të dhënat që kanë rezultuar prej tyre.

Gjyqtarja është njoftuar për aktet e vlerësimit. Nuk ka paraqitur kundërshtime. Nuk ka paraqitur kërkesë për prova të reja dhe njëkohësisht nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore.

Në vijim po relatoj analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi në cilësinë e relatores.

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarës {...} është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit ‘Për statusin’, për aq sa ato janë të zbatueshme në pjesën e vlerësimeve si dhe akteve nënligjore të miratuara së fundmi nga ana e Këshillit mbi vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në KLGJ, ku në një dispozitë tranzitore rregullohet e gjithë procedura e gjyqtarëve të komanduar para fillimit të funksionimit të Këshillit, por në kohën kur ata ushtronin detyrën e inspektorit në ish–KLD.

Për sa i përket kriterit të parë “Aftësitë profesionale”, aspekti “Njohuritë ligjore”, 1.A.a Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, nga tërësia e burimeve të vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore, ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes/ankesës objekt shqyrtimi, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar me të dhënat/faktet që rezultojnë nga dokumentacioni dhe informacioni i marrë për efekte të verifikimit të ankesës, pasqyrimin e veprimeve procedurale të kryera gjatë procedurës së verifikimit, etj. Gjithashtu, rezulton aftësia e gjyqtarës së komanduar në pozicionin e inspektore për grumbullimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të nevojshme të marra nga burimet e vlerësimit për qëllime të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, në përputhje me kriteret e caktuara në ligj dhe rregulloren “Mbi sistemin e vlerësimit profesional dhe

etik të gjyqtarëve”. Sa i përket identifikimit të normës/normave të akteve ligjore dhe nënligjore, në të gjitha dokumentet burim vlerësimi referohen dispozita të ligjit dhe akteve nënligjore të ish–KLD–së lidhur me procedurën e verifikimit/ inspektimit apo ato të vlerësimit etik dhe profesional. Përbën vlerë të shtuar, identifikimi dhe referimi në mbështetje të arsyetimit ligjor, kryesisht në parashtrimet që gjyqtarja ka përgatitur për Gjykatën e Lartë apo për Gjykatën Kushtetuese në aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor, vendime të GJEDNJ–së, vendime të Gjykatës Kushtetuese, etj. Për këtë arsye, për treguesin e parë të kriterit të aftësive profesionale, propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 25 pikë.

Për sa i përket 1.A.b Aftësisë për të interpretuar ligjin, është bërë në fakt një analizë e të gjitha dokumenteve ligjore që kanë qenë në dosjen e vlerësimit, kanë qenë relacione për verifikim ankese, kanë qenë raporte konstatues vlerësimi etik dhe profesional dhe parashtrime për përfaqësim gjyqësor. Në të gjitha këto dokumenta ligjore të vlerësuara, ka rezultuar se gjyqtarja e komanduar në funksionin e inspektores ka shfaqur aftësi të larta në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm dhe në mbështetje të opinionit të saj lidhur me trajtimin dhe propozimin për zgjidhjen e çështjeve konkrete, ajo ka referuar në interpretimin jo vetëm abstrakt por edhe atë të ndërthurur me faktet e çështjes që kanë rezultuar nga procedura e verifikimit.

Për këtë arsye, edhe për kriterin e dytë pikëzohet me 25 pikë.

Për sa i përket 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria, të gjitha dokumentat e hartuara prej saj bëjnë një pasqyrim të qartë, konciz dhe të saktë të ankesës apo çështjes objekt verifikimi, apo evidentimit të dokumentave dhe informacioneve të marra në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, analizës së të dhënave, arsyetimit dhe paraqitjes së përfundimeve të nxjerra sipas kriterëve matëse të vlerësimit. E njëjta shkallë kujdesi evidentohet edhe në drejtim të kuptueshmërisë të mendimit të shprehur lidhur me parashtrimet e përgatitura prej saj në çështje gjyqësore. Treguesi propozohet 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjore – në projektraport vlerësimi janë ndarë dokumentat sipas natyrës së tyre, relacionet për

verifikimin e ankesave, raportet konstatuese për vlerësim etik dhe profesional si dhe dokumentat ligjorë. Të gjithë dokumentat kanë një strukturë të organizuar, që ndjekin një rrjedhë logjike, që i bën ato të kuptueshme dhe që orientojnë drejt dhe saktë lidhur me atë çka parashtrohet dhe konkluzionin e arsyetuar nga gjyqtarja. Për këtë arsye, pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket 1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik, në tërësi shkalla e analizës dhe argumentimit logjik, pavarësisht në masë të ndryshme e kushtëzuar kjo nga natyra komplekse ose jo e çështjes, evidentohet e lartë. Evidentohet aftësia e gjyqtares për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në ankesë/çështjen e marrë në shqyrtim, dhënia e argumenteve të plota dhe koncize lidhur me zbatimin e ligjit mbi këto fakte. Po ashtu, rezulton aftësia e saj për të evidentuar në raste specifike çështjet ligjore që duhet të vlerësoheshin nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u shoqëruar dhe me një analizë ligjore lidhur me to. Analiza dhe argumentimi logjik ndjek kryesisht rregullin: fakt-çështje-normë-interpretim-konkluzion dhe argumentimi logjik ka vijueshmëri duke u evidentuar veçanërisht interpretimi individual i ligjit nga ana e saj si dhe aftësia për të ngritur çështje për të cilat duhet të bëhen objekt diskutimi nga Këshilli, me qëllim aplikimin e standardeve të njëjta për vlerësimet e gjyqtarëve. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së gjyqtares për këtë tregues vlerësohet aftësia e saj shumë e lartë dhe pikëzimi me 25 pikë, ku ndikon edhe fakti që nga burimet e vlerësimit nuk ka rezultuar që dokumentet ligjore të hartuara prej saj të jenë kthyer nga organet kontrolluese, që ka qenë Kryeinspektori, për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në dokumentet ligjore.

Propozimi për kriterin e parë është 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

Për sa i përket “Aftësisë organizative” – “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, ka rezultuar që në të gjithë periudhën e vlerësimit ajo ka përfunduar 61 raporte konstatues, duke tejkaluar standardin sasior me 16 vlerësime ose 36%, por njëkohësisht ka përfunduar edhe 32 praktika të tjera të trajtuara si trajtime ankesash, kryerje inspektimesh tematike, për të cilat janë bërë edhe relacionet përkatëse, përfaqësim



gjqësor, pjesëmarrje në grupe pune, të cilat konsiderohen në volumin tërësor të punës së inspektorit, dhe për këtë arsye pikëzimi është maksimal me 25 pikë. Marrë parasysh këtu që i njëjti konstatim është bërë edhe nga ana e Kryeinspektorit në vlerësimin e gjyqtarës në vitin 2013 dhe 2014.

Për sa i përket treguesit 2.A.b. Aftësia për të respektuar afatet, të gjitha relacionet dhe dokumentat janë hartuar brenda afateve prioritare të ngutshme, normale të përcaktuara nga ana e Kryeinspektorit. Ka dy materiale në fakt që kanë rezultuar të përfunduara jashtë afateve, por këto dy materiale në tërësinë e periudhës së vlerësimit, janë të dyja të vitit 2014, bashkë me çështjet e tjera, zënë 6.16% të materialeve të trajtuara jashtë afatit. Ndërsa në vitin 2013 të dhënat burimore flasin për materiale të trajtuara jashtë afatit me 6.5%.

Duke marrë parasysh tejkalimin pothuajse shumë të papërfillshëm të afatit ligjor, edhe nga ana e Kryeinspektorit aftësia e gjyqtarës në drejtim të këtij treguesi është pikëzuar shumë e lartë në vlerësimin që është bërë, e njëjta gjë propozohet edhe nga ana ime, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër 2.B. Efektiviteti dhe metodologjia, në përgatitjen dhe dokumentimin e punës, referuar të gjitha të dhënave që lidhen me të, në funksion të organizimit të punës apo trajtimit të rasteve, efektiviteti dhe metodologjia për kryerjen e vlerësimeve profesionale, rezulton e lartë dhe nëpërmjet ndjekjes së një modeli pune të pranuar nga ana e seksionit të vlerësimeve. Për pasojë, aftësitë e saj për këtë tregues janë shumë të larta dhe pikëzohen maksimalisht me 25 pikë.

Për sa i përket 2.C Rregullshmërisë dhe saktësisë, për të dy këto tregues, aftësitë janë shumë të larta, dosjet paraqiten të rregullta në renditje, nuk ka mungesë dokumentacioni apo dokumentacion që nuk i përket trajtimit të çështjes konkrete. Pikëzimi është respektivisht me 10 dhe 15 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e “Aftësive organizative” propozohet nivel i lartë i vlerësimit, pikëzimi 100.

Për “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, duke qenë se shumica e treguesve të këtij kriteri bazohen mbi parimin e prezumimit dhe në mungesë të të

dhënave që mund të ndikonin negativisht në pikëzimin e çdo treguesi është propozuar pikëzim maksimal për 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, marrë parasysh që nuk ka të dhëna për verifikim ankesash gjatë periudhës së rivlerësimit 2013–2016 për gjyqtaren. Nga ana e KPK-së janë marrë në shqyrtim në vendimin e vet disa ankesa të qytetarëve, por ato i përkasin periudhës së vlerësimit mbas vitit 2017 dhe janë trajtuar në raportin e saj të vlerësimit 2017–2019.

Ndërkohë, për “integritetin e gjyqtares”, edhe për sa i përket raportit të ILDKPI-së dhe vendimit të Komisionit referuar pastërtisë dhe figurës dhe njëkohësisht edhe pasurisë së saj, ka të dhëna pozitive. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 40 pikë.

Për sa i përket “Përdorimit të gjuhës diskriminuese” gjithashtu është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, e cila ka rezultuar për shkak të evidentimit se në të gjitha dokumentet e përdorura nga ana e gjyqtares apo në komunikimin verbal ose në përpilimin dhe komunikimin me kolegët e saj nuk rezulton që të ketë përdorur gjuhë diskriminuese dhe fyese, qoftë në trajtimin e rasteve në rastet e verifikimit të ankesave, ashtu edhe në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, kur ajo duhet të përpilonte raportet konstatues të vlerësimit.

Nuk ka pasur të dhëna për dorëheqje. Për këtë arsye, edhe për sa i përket treguesit të fundit që është “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit” është propozuar një shkallë shumë e lartë aftësie, 15 pikë, duke e konsideruar këtë numër të pa konsiderueshëm.

Përfundimisht për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, propozohet pikëzimi me 100 pikë.

Për sa i përket kriterit të katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, shkallë shumë e lartë aftësie për treguesit 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent, 4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, 4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale, 4.B.b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit, ky fakt është evidentuar edhe gjatë hartimit të raportit analitik të Këshillit për efekt të organeve të rivlerësimit, është

evidentuar edhe në vlerësimin që Kryeinspektorja i ka bërë gjyqtarës së komanduar, pasi në mënyrë sistematike ka marrë pjesë në të gjitha grupet e punës që kanë të bëjnë: për hartimin e programit vjetor të trajnimeve; për rishikimin e projekteve të ndryshme të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë; në grupin e punës për sa i përket Rrjetit Evropian të Këshillave të Lartë Gjyqësorë për hartimin e “Manual i Standardeve Gjyqësore Minimale në Procedimet Disiplinore të Gjyqtarëve”; përfaqësime gjyqësore, etj. Për këtë arsye, duke qenë se ka pasur të dhëna, propozohet pikëzimi me 5 pikë.

Shkallë shumë e lartë aftësie është edhe për sa i përket treguesit 4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë.

Për sa i përket 4.C.a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues, gjatë gjithë periudhës së vlerësimi rezulton që ka marrë pjesë në trajnime brenda dhe jashtë vendit në total 31 ditë. Sipas metodologjisë, pikëzohet me 20 ditë.

Për sa i përket 4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve, rezulton se ka qenë eksperte dhe lehtësuese në tre trajnime të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës për “birësimin e fëmijëve ...”, “vlerësimin profesional ...” dhe “procedimin disiplinor të gjyqtarëve...”, të gjitha këto të zhvilluara në periudhën 2015-2016. Për këtë arsye pikëzimi edhe për këtë tregues është 5 pikë.

Për sa i përket 4.C.c. Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, gjithashtu rezultojnë të dhëna:

(i) Pjesëmarrje në takimet e Këshillit Drejtues për të lehtësuar zbatimin e projektit “Mbështetje për efikasitetin e drejtësisë SEJ”, financuar nga BE dhe KE;

(ii) Pjesëmarrje në takimet e misionit TAIEX lidhur me bashkëpunimin me ILDKPKI në luftën kundër korrupsionit.

Përveç tyre ajo gjatë kësaj periudhe është angazhuar edhe si pedagoge e jashtme në Departamentin e të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, referuar një vërtetimi të paraqitur nga ky fakultet për vitet 2013–2014 dhe 2014–2015. Gjithashtu një veprimtari tjetër ndërinstitucionale e saj konsiderohet edhe angazhimi si eksperte në projektin e edukimit ligjor të rinisë, të zhvilluar në kuadër të Ambasadës

Gjermane, në përfundim të të cilit është bërë edhe një udhëzues/manual. Për këtë arsye është pikëzuar me 5 pikë edhe sipas këtij treguesi.

Për sa i përket treguesit të fundit 4.C.ç. Publikimet ligjore akademike, në fakt gjyqtarja ka paraqitur një botim të saj, “Udhëzues për mësuesit e lëndës së qytetarisë”, botimi “Edukimi ligjor dhe qytetar”, i botuar nga Qendra “Ekipi për Informim dhe Studim Ligjor”, në vitin 2016. Por ky botim nuk është konsideruar, nga ana ime si relatore, si botim shkencor akademik i botuar në revistën shkencore me bord editorial, pasi revista nuk ka qenë e pajisur me numër identifikimi ISBN–ISSN, por ka qenë një publikim që i shërben edukimit ligjor të komunitetit dhe nuk i shërben zhvillimit të doktrinës. Për këtë arsye nuk është pikëzuar në lidhje me këtë tregues. Është pikëzuar me 0 pikë.

Përfundimisht është pikëzuar me 95 pikë për kriterin e katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”.

Përfundimisht për të katër kriteret propozohet vlerësimi 100 pikë “Aftësia profesionale”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”; 100 pikë “Aftësia organizative”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”; 100 pikë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”; “Aftësia personale dhe angazhimi profesional” 95 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Përfundimisht niveli i vlerësimit të saj është “Shkëlqyeshëm”, pikët 395.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit znj. Ukperaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

Nuk ka diskutime për projektvendimin përkatës.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës znj. {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013–2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:

A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

45



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.05.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (relator z. Alban Toro).

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:03 dhe mbaroi në orën 12:05.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
2. **Klodian Kurushi** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Irena Plaku** (anëtare)
5. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Brikena Ukperaj** (anëtare)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Klodiana Vogli, përfaqësuese – OPDAT – Ambasada Amerikane.*

5. *Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtim i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (relator z. Alban Toro).

*Ilir Rusi:* Për më tej vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës: Shqyrtim i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Më herët me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 në kuadër të përpjekjeve që KLGJ ka bërë për plotësimin e pozicioneve të lira në gjykata të ndryshme, por në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të Posaçëm si dhe Gjykatën Administrative të Apelit, është proceduar duke filluar procedurat e ngritjes në detyrë. Aktualisht në këtë kandidim kanë marrë pjesë disa kandidatë të cilët po i citoj: znj. {...}, z. {...}, z {...}, znj. {...} dhe znj. {...}. Gjatë procedurës së verifikimit, tre nga kandidatët konkretisht znj. {...} e cila kishte kandiduar për ngritje në detyrë edhe për pozicione të tjera me Dekretin e Presidentit nr.13477, datë 16.02.2022 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë; znj. {...} e cila kishte kandiduar për ngritje në detyrë edhe për pozicione të tjera me vendim e Këshillit nr.90, datë 23.02.2023 është ngritur në detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Apelit; z. {...} i cili kishte kandiduar për ngritje në detyrë edhe për pozicione të tjera, me vendim e Këshillit nr.107, datë 25.03.2022 është tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion.

Përfundimisht, për pozicionin e lirë të shpallur me vendim nr. 290, datë 06.07.2021 për Gjykatën Administrative të Apelit kanë mbetur vetëm dy kandidatë konkretisht znj. {...} dhe z. {...}.

Në procedurën e përzgjedhjes për këtë pozicion të shpallur me vendimin e Këshillit u përfshinë këto dy kandidatë znj. {...} dhe z. {...}, për të cilët u verifikua plotësimi i kërkesave të ligjës për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditjeje nga shkronja "a", pika 9 e nenit 48, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në shkronjën "c", pika 7 dhe në pikën 46 të vendimit 70/2020.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja "a", të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të Vendimit 70/2020.

Siç u parashtrua, në pikën 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: "9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas



rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, ...”. Ndërsa në pikën 12 të vendimit 70/2020, përcaktohet se: “Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

Për znj. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr.225, datë 08.05.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 72, datë 13.02.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2017–2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;

b) Për z. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 196, datë 12.05.2021, kandidati është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 197, datë 12.05.2021, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidatja znj. {...}, të ketë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Ndërsa kandidati z. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, identifikohen kandidatja znj. {...} me rezultate më të larta.

Pra renditja përfundimtare për këtë pozicion të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, rezulton të jetë: 1) Znj. {...}; 2) Z.{...}.

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 19.2, të këtij relacioni, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 20 të tij, është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni si më poshtë:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};

2. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

Meqenëse nuk ka diskutime të vazhdohet me miratimin e projektvendimit përkatës.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};

2. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.05.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023”.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:03 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*3. Rezarta Taushani, Vjollca Kola, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Klodiana Vogli, përfaqësuese – OPDAT – Ambasada Amerikane.*

*5. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

*6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

*7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtim i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023”.

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës: Shqyrtim i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023”. Për më tej fjalën relatorit përkatës.

*Xhevdet Haxhiu:* Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), për vitin 2023, në shumën 4,362,600 mijë lekë, i ndarë në tre programe buxhetore: programi

01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, programi 01140, “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, dhe programi 03310, “Buxheti Gjyqësor”.

Fondet buxhetore të miratuara për vitin 2023, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, janë në shumën prej 4,025,000 mijë lekë (të ndara në shpenzime page, shpenzime sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime kapitale në investime).

Mbështetur në legjislacionin "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", KLGJ me vendimin nr. 560, datë 29.12.2022, ka detajuar fondet buxhetore për vitin buxhetor 2023, për të gjithë sistemin gjyqësor, ashtu edhe për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, për gjykatat e të gjitha niveleve.

Fondi i detajuar për gjykatat e të tre niveleve në shpenzime personeli ka qenë në shumën 2,301,300 mijë lekë, dhe u mbajt një pjesë në administrim në programin 03310 KLGJ – 388,400 mijë lekë.

Detajimi i shumës së mësipërme me vendim është bërë duke u mbështetur në numrin faktik të punonjësve (magjistratë dhe administratë gjyqësore) si dhe parashikimet për plotësimin e vendeve vakante, sipas akteve ligjore në fuqi në sistemin gjyqësor. Gjithashtu duhet të përmendim se është mbajtur parasysh edhe riorganizimi i gjykatave i cili tashmë është bërë i mundur në nivel apeli dhe gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

Fondi i mbajtur në administrim në 03310 KLGJ është mbajtur me qëllimet e mëposhtme:

- Fondi e përlllogaritur për 40 magjistratët e rinj të cilët pritet të emërohen nga KLGJ në korrik 2023;
- Fondi për punonjësit shtesë të administratës gjyqësore, që u akordua në vitin buxhetor 2023;
- Diferenca e fondeve të programuara për gjykatat cilat tashmë janë mbyllur dhe nuk funksionojnë më (nivel apeli dhe nivel të juridiksionit të përgjithshëm).

Në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022, “Për organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, nuk ekzistojnë më Gjykatat e

Apelit të Durrësit, Korçës, Gjirokastrës, Shkodrës, dhe Vlorës si dhe gjykatat e rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Pogradec, Tropojë, Kurbin, Pukë, Krujë. Punonjësit e ish gjykatave të apeleve dhe gjykatave të rretheve gjyqësore (magjistratë dhe administratë gjyqësore) janë transferuar në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në disa gjykata të rretheve gjyqësore.

Duke pasur në vëmendje edhe vendimin e KLGJ “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave” si dhe rishpërndarjen e numrit të punonjësve, ka pasur edhe një efekt zbatimi VKM-së nr. 919/2020 për kategorinë e pagave të punonjësve sipas kategorive të gjykatave në lidhje me fondet në shpenzime personeli për administratën gjyqësore.

Kështu, nisur nga sa diskutova më sipër lind nevoja e rishpërndarjes së fondeve në shpenzime korrente dhe në shpenzime kapitale në programin 03310 “Buxheti i gjykatave”, sipas pasqyrës 1 bashkëlidhur (që të gjithë besoj e keni përpara në dokumentet që janë nisur me e-mail).

Në shpenzime personeli ka lindur nevoja për rishpërndarje për Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit, për Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë, Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Siç dihet gjykatat administrative ushtrojnë funksionin siç kanë qenë të organizuara më parë, deri në përfundimin e riorganizimit të tyre.

Po kështu ka lindur nevoja edhe për shpenzime për mallra e shërbime të tjera (shpenzime operative). Nevojat këtu kanë lindur për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjykatë Dibër, Juridiksioni i Përgjithshëm Durrës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë,

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër.

Ndërsa në shpenzime kapitale, si rezultat i mbylljes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor që thamë më sipër, kishim detajuar një fond prej 300 mijë lekësh në “Blerje pajisje zyre”, që konsiston për blerjen e kondicionerëve për sallat e gjyqit, por që nuk u realizua dhe për këtë qëllim kërkojmë transferimin e saj nga Gjykata e Lushnjës në KLGJ (këtu), që të shihet në një moment të dytë për t’u përdorur për nevojat e gjykatave të tjera në vazhdim të vitit buxhetor 2023.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606) dhe shpenzime kapitale (231), për vitin buxhetor 2023, sipas pasqyrave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar!

Në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit z. Haxhiu!

Ka pyetje apo diskutime për sa u parashtrua?

Atëherë, meqenëse nuk ka pyetje dhe diskutime, të kalohet në votimin e projektvendimit përkatës.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Zonja Shehu!

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.



***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi***: Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606) dhe shpenzime kapitale (231), për vitin buxhetor 2023, sipas pasqyrave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me diskutimet dhe vendimmarrjen përkatëse për këtë pikë të rendit të ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**